

Tiranë, 01.02.2020

Akt themelimi

i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar

“Crown Boutique Hotel & Spa”

Sot, më datë 01.02.2020, mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007” Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lirë, tëshprehur edhe në nënshkrimin e këtij Akt Themelimi nga ortaku i vetëm:

Z. Fatjon SELIMAJ, i biri i Ismajl, i ditëlindjes 02.04.1985, lindur në Bajram Curri, Tropojë dhe banues në Tiranë, rruga Mithat Frashëri, 40, Paskuqan, Kamëz, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi juridike per te vepruar.

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur “Crown Boutique Hotel & Spa” shpk. Shoqëria do ti nënshtronhet legjislacionit shqiptar. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të ketij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues të shoqërisë.

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare private “Crown Boutique Hotel & Spa” shpk, do të ketë selinë e saj në rrugën George W Bush, nr. 17, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të kriojojë filiale si brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve.

Objektivi i veprimitarisë

Neni 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e mëposhtme:

3.1 Shërbime hotelerie

3.2 Shërbime SPA

3.3 Shërbime turizmi

3.4 Shoqëria do të jetë në ndërtim vitin e parë dhe do të nisë aktivitetin e saj normal në një moment të dytë, i cili do të njoftohet nga shoqëria.

Kohëzgjatja e shoqërisë

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në cdo kohë dhë për cfarëdo lloj shkaku.

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5

Kapitali filletar i shoqërisë me përgjiegjësi të kufizuar “Crown Boutique Hotel & Spa” do të jetë 100 000 (njëqind mijë) lekë. Kapitali është 100% i ortakut të vetëm. Kapitali filletar mund të shtohet ose të pakësohet.

Drejtimi i Shoqërisë

Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj dhe përfaqësuesi i saj ligjor. Ai është përfaqësuesi i saj ligjor në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Cdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në mungesë të tij nga një përfaqësues të pajisur me një prokurë të posacme.

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut të vetëm të shoqërise.

Neni 8

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në përputhje me legjislacionin shqiptar, në gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj, me logon dhe tekstin e saj brenda.

Neni 10

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të ëplotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanërisht të ligjit Nr. 9901, data 14.04.2008, "Për Krijimin e Shoqërvë Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri. Cështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statutin e Shqoërisë.

Neni 11

Akti i themelimit, u përpilua në 5 kopje, për tju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të ngelet në dokumentacionin bazë të shoqëris "Crown Boutique Hotel & Spa" shpk

Akti i themelimit u nenshkrua rregullisht nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

"Crown Boutique Hotel & Spa"

Fatjon SELIMAJ

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Fatjon Selimaj". Below it is a stylized, cursive signature.